



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 672117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
  - Edukim Artistik në Instrumentet Frymore, BMus, 240 ECTS, maksimumi 12 student për vit akademik;
  - Teknologji Ushqimore, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 student për vit akademik.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar kërkesën e Universitetit “Haxhi Zeka” për ri/akreditim të programeve të cekura më sipër. Duke pasur parasysh dinamikën e përcaktuar nga AKA për formimin e ekipeve të vlerësimit dhe përcaktimin e afateve kohore për vlerësim të jashtëm, Universitetit të Pejës nuk i është realizuar vizita me ekspertë të jashtëm sipas afateve të parapara nga AKA dhe rrjedhimisht është vonuar regjistrimi i studentëve të rinj në këto programe të studimit. Duke pasur parasysh që këto programe janë në ri/akreditim dhe se kriteret minimale për stafin akademik janë plotësuar, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, kërkesën e Universitetit “Haxhi Zeka” për riakreditim të programeve të studimit, dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitave të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimet të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Haxhi Zeka";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

